



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	<u>M1/RM</u>
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	<u>-04-</u>
Nr. i Prot. Bashk. Prot. Prot. No.	<u>969/12</u>
Data :	<u>22.03.2012</u>
Date :	<u>22.03.2012</u>
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

**MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM
NË MES
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
DHE
KOMUNËS SË DEÇANIT**

Duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi Ministria Infrastrukturës është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës, ndërsa Komunitat për rrugët lokale;

Ministria e Infrastrukturës dhe Komunitat janë pajtuar për bashkëfinancim të projekteve të infrastrukturës rrugore me qëllim të përmirësimit të gjendjes të rrugëve lokale.

Si rezultat i kësaj palët janë pajtuar me këtë Marrëveshje bashkëfinancimi (Marrëveshje) duke u bazuar në afatet dhe kushtet e dhëna në vazhdim:

Neni 1

1.1 Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Deçanit, do të bashkëfinancojnë projektin: **Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Pejë - Deçan, segmenti Lëbushë - Isniq - Deçan**

1.2 Vlera e projektit është **180,000.00 €**.

- Ministria e Infrastrukturës do të financoj këtë projekt me 160,000.00 € (Njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro).
- Komuna e Deçanit do të financoj projektin me 20,000.00 € (Njëzet mijë euro).

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E DEÇANIT - OPŠTINA DEČAN - DEČAN MUNICIPALITY	
Nr. i Prot. Br. Prot. Prot. No.	<u>1065</u>
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	<u>02</u>
Data :	<u>22.3.2012</u>
Date :	<u>22.3.2012</u>
DEÇAN, DEČANE	

Neni 2

Përgjegjësitë e Ministrisë së Infrastrukturës

- 2.1 Pjesëmarrja financiare e Ministrisë së Infrastrukturës në bashkëfinancim do të jetë: **160,000.00 €** (Njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro).
Ministria e Infrastrukturës nga buxheti i vitit 2012 do të siguroj **50,000.00 €** (Pesëdhjetë mijë euro), ndërsa nga buxheti i vitit 2013 do të siguroj **110,000.00 €** (Njëqind e dhjetë mijë euro).
- 2.2 Pagesat sipas participimit të Ministrisë së Infrastrukturës, do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve sipas kushteve të kontratës.
- 2.3 Ministria e Infrastrukturës do marrë pjesë në vlerësimin e ofertave për zgjedhjen e kontraktuesit dhe në vlerësimin teknik dhe financiar pas përfundimit të punimeve.

Neni 3

Përgjegjësitë e Komunës së Deçanit

- 3.1 Komuna e Deçanit do të financojë projektin me **20,000.00 €** (Njëzet mijë euro).
- 3.2 Komuna e Deçanit do të udhëheqë projektin, procedurat e prokurimit dhe do të nënshkruaj kontratën.
Pagesat e parapara në pikën 3.1, do të alokohen nga Komuna vetëm për shpenzimet e realizimit të kontratës, për punët e aprovuara nga menaxheri i projektit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 3.2 Finalizimi i kontratës në mes të Komunës dhe kontraktuesit do të bazohet në procesin e vlerësimit përfundimtar tekniko-financiar, në të cilin Ministria e Infrastrukturës do të jetë pjesëmarrës në përputhshmëri me të drejtat e saj si palë në bashkëfinancim.
- 3.3 Komuna e Deçanit në intervale të rregullta kohore dhe në raste tjera, kur kjo është e domosdoshme do të dërgoj Ministria e Infrastrukturës këto të dhëna:
- a) Kopjet e kontratës
 - b) Kopjet e raporteve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së punimeve
 - c) Raportet për përmbushjen e kontratës
 - d) Detajet e pagesave të bëra sipas kontratës
- 3.4 Marrëdhëniet pronësore-juridike do të zgjidhë Komuna e Deçanit në bashkëpunim me këshillin e komunitetit të fshatrave nëpër të cilat kalon trotuari.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe zotimet e përbashkëta

- 4.1 Komuna ka autoritetin dhe përgjegjësinë të lidhë kontratën me kompaninë e cila është vlerësuar si më e përgjegjshme teknikisht dhe financiarisht dhe të emërojë Menaxherin i cili do të mbikëqyrë dhe menaxhoj realizimin e projektit.
- 4.2 Ministria e Infrastrukturës do të emëroj mbikëqyrësin për përcjelljen e realizimit të kontratës me kompetenca të plota sikurse organi mbikëqyrës i Komunës.
- Inxhinieri i emëruar nga Ministria e Infrastrukturës do ti raportoj Autoritetit nga i cili është emëruar.

Neni 5

Praktikat jo etike

Palët ndajnë shqetësimin e përbashkët lidhur me korrupsionin, i cili e rrezikon udhëheqjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin dhe rrezikojnë konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi. Palët deklarohen se çfarëdo oferte, dhuratë, shpërblim ose ndonjë përfitim tjetër, i cili është kryer ose duhet të kryhet me njohuri të drejtpërdrejtë apo tërthore të palëve, nga ndonjë person që ka lidhje me përmbushjen e kësaj marrëveshje, ose nga çfarëdo kontratë tjetër e lidhur me të, do të konsiderohet akt jo legal dhe korrupsion.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti, përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore. Ndonjë konflikt, kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes duke përfshirë esencën e saj, validitetin apo përfundimin duhet të zgjidhet nga gjykata kompetente.

Neni 7

Amendamentet

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 8

Afati

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 9

Përfundimi

Palët mund të shkëpusin marrëveshjen për asfaltimin e rrugës, me akt të njëanshëm duke dhënë 30 (tridhjetë) ditë afat me njoftim paraprak, në formë të shkruar palës tjetër.

Ministria e Infrastrukturës

Z. Fehmi Mujota - Ministër



Komuna e Deçanit

Z. Rasim Selmanaj - Kryetar

